



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1098 prot.

Himarë, më 30.01.2025

VENDIM

Nr. 04 datë, 30.01.2025

**BASHKËFINANCIMI PREJ 50% TË VLERËS DO TË APLIKOHET NË DY
PROGRAMET E STREHIMIT: PËR RESTAURIMIN E BANESAVE SHUMË
TË AMORTIZUARA PËR FAMILJET NË NEVOJË DHE PËR
PROGRAMIN E STREHIMIT TË PËRKOHSHËM, SI DHE PËR
ADAPTIMIN E OBJEKTEVE EKZISTUESE, NË KUADËR TË ZBATIMIT
TË PROJEKTIT TË STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2025.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 42, datë 20.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2025” të Këshillit Bashkiak Himarë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 30.01.2025 pasi shqyrtoi materialin e miratoi me 14 pro, 0 kundër dhe 0 abstenim dhe si më poshtë,

VENDOSI:

1. Restaurimin e banesave shumë të amortizuara në zbatim të projektit të strehimit social për vitin 2025 sipas pikës 7 të udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret e përfitimit të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2025 dhe fondit të strehimit social që Ministria e Financave do t’u jap bashkive për të përballuar kostot totale të projektit për përmirësimin e kushteve $\leq 70\%$ të kostos së ndërtimit të një objekti të ri referuar kostos mesatar të ndërtimit në fuqi miratuar me VKM nr.3, datë 28.12.2016 dhe referuar normave të strehimit në fuqi sipas anëtarëve të një familjeje bazuar në certifikatën familjare.
3. Ngarkohet drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

